



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA R. SHEHU
ADRESA Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3/3
TEL: 0692091283



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)


Nr. repertori: 8394

Nr. koleksioni: 3993

Tirane më 11/11/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022052820452989477





A2022052820452989477

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË “ _____ ” SH.P.K)

Sot, më datë _____, para meje Notere MIMOZA R. SHEHU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3/3, u paraqit personalisht:

SHITES:

Shoqëria ARKONSTUDIO, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L42019004I, me adresë Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33, përfaqësuar nga Administratori Nasjel Çiço, atësia Gjergji, amësia Kozeta, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në TIRANË, me adresë Muharrem Butka; Nd. 20; H. 3; Ap. 19; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 30/01/1987, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034207091 dhe nr. personal I70130120E.

BLERES:

Shoqëria Premium Construction & Maintenance, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11816005V, me adresë Rruga 365, Pallati Nr.8, Kati I 8, Apartamenti B, përfaqësuar nga Administratori Hektor Agalliu, atësia Nuri, amësia Zyrako, shtetas Shqiptar, lindur në Tërpan, Berat dhe banues në Dimal, me adresë Engjell Agalliu; Nd. 037; H. 0; Ap. 0; Uravajgurore; Ura Vajgurore; 5007; Dimal, lindur më 27/01/1957, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033459666 dhe nr. personal F70127128J.

Shitësi dhe Blerësi janë referuar me poshtë individualisht si “*Pala*” dhe se bashku si “*Palër*”.

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 25% te kuotave te Kapitalit te Shoqërisë Koncesionare “Vlora Harbor Construction & Maintanance”, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, e regjistruar ne regjistrin themeltar me NUIS M21806032P, me adrese Tirane, Rruga 365, Pall nr.8, kati 8, Apartamenti B, Tirane, e themeluar për zbatimin dhe përmbushjen e kushteve te Kontratës se Koncesionit nr.554 repertori, nr.203 koleksioni date 29/04/2022 nënshkruar ndërmjet Ministrisë se Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktor) dhe Bashkimit te operatoreve ekonomike “Agbes Construction” shpk, “Besta” shpk, “Premium Contruction & Maintenance” shpk, “Ite Grup” shpk dhe “Arkonstudio” shpk “Për dhënien me koncesion/partneritet publik privat për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e “Portit te Integruar” ne Triport Vlore.
- B. Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000,000 (një milion) leke, te ndara ne kuota, te cilat janë nënshkruar dhe derdhur rregullisht dhe ne mënyrë te vlefshme.

Aktualisht palët zotërojnë tek shoqëria koncensionare “Vlora Harbor Construction & Maintenance” shpk kuotat si me poshtë:

-“Premium Contruction & Maintenance” shpk, zotëron një kuote me vlere 370,000 (treqind e shtatedhjetë mijë) leke, qe përfaqëson 37 % te kapitalit themeltar.





A2022052820452989477

-“ARKONSTUDIO” shpk, zotëron një kuotë me vlerë 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, qe përfaqëson 25 % te kapitalit themeltar.

Me ane te kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me ane te shitblerjes, ne mënyrë te barabarte, 100 % te vlerës se kuotës se tij, e barasvlershme me 250,000 lek, vlere e cila përbën 25% te kapitalit themeltar te shoqërisë “Vlora Harbor Construction & Maintenance” shpk .

- C. Me ane te kësaj kontrate, Blerësi “Premium Contruction & Maintenance” " shpk, përveç zotërimit qe ka për 37% te kapitalit themeltar, dëshiron te blejë edhe 25% te Kapitalit te Shoqërisë te cilat i zotëron Shitësi, duke u bere zotërues i ligjshëm për 62% te kapitalit themeltar te Shoqërisë Koncesionare “Vlora Harbor Construction & Maintenance” shpk.
- D. Ne përputhje me nenet e Statutit te shoqërisë dhe Ligjit shqiptar “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, Nr. 9901 date 14.04.2008 me ndryshimet përkatëse, me ane te Vendimit te Ortakeve te shoqërisë “ARKONSTUDIO” shpk, është vendosur miratimi i shitjes se 100 % (njëqind përqind) te kuotave te zotëruara ne Shoqërinë Koncesionare “Vlora Harbor Construction & Maintenance” shpk tek Blerësi.
- E. Në bazë të Statutit të shoqërisë “Vlora Harbor Construction & Maintenance” Shpk (“**Statuti**”) kuotat mund te transferohen lirisht mes ortakeve dhe asnjeri prej ortakeve te shoqërisë nuk ka ndonjë kundërshtim ne lidhje me këtë.

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate për shitjen e kuotave nëpërmjet Shitësit dhe Blerësit (“**Kontrata për Shit-Blerjen e Kuotave**” ose “**Kontrata**”), si me poshtë vijon:

NENI 1 Përkufizime

- 1.1 Përveç shprehjeve te tjera te përkufizuara ndryshe ne këtë Kontrate, për qëllimet e saj, fjalët dhe shprehjet qe vijojnë do te kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Kontrate”	do te thotë kjo Kontrate për Shit-Blerje Kuotash – duke përfshire si pjese përbërëse te saj, deklaratat paraprake te mësipërme;
“Shoqëria”	do te thotë Shoqëria Koncesionare “Vlora Harbor Construction & Maintanance” Shpk me NIPT M21806032P, me seli ne adresën: Rruga 365, Pall nr.8, kati 8, Apartamenti B Tirane.
“QKR”	nënkupton Qendrën Kombëtare te Regjistrimit / Qendrën Kombëtare te Biznesit
“Leke”	monedha qe përdoret aktualisht ne Republikën e Shqipërisë;
“Euro”	nënkupton monedhën qe përdoret ne Bashkimin Evropian;

REPUBLIC
MINISTRY
OF
NATURAL RESOURCES
& ENVIRONMENT
CITY



A2022052820452989477

"Data e Kontratës" nënkupton datën në të cilën palët kanë nënshkruar këtë kontratë dhe përbën datën në të cilën Kontrata hyn në fuqi në të gjitha efektet ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar;

"Barre" do të thotë çdo hipoteke, detyrim, peng, garanci, e drejte zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta për t'u ofruar i pari në blerje, e drejta ose interesi i një pale të trete, barre ose interesa siguruese të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marrëveshjeje kontrolluese) me efekte të ngjashme;

"Pala" ose "Palët" do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç e kërkon përmbajtja;

"Çmimi i Blerjes" do të thotë çmimi që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Kuotave, siç përcaktohet në Nenin 3 të kësaj Kontrate;

"Kuota në Shitje" do të thotë kuota të barabarta me 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 2

Objekti i Kontratës

- 2.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ("Data e Nënshkrimit"), Shitësi i shet Blerësit "Premium Contruction & Maintenance" shpk, 100 (njëqind) % të kuotës që zotëron e cila përfaqëson 25 % (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, të lira nga çdo barre.
- Kuota në Shitje do të transferohen juridikisht nga pronësia e Shitësit në pronësi të Blerësit "Premium Contruction & Maintenance" shpk dhe pala Blerëse do të bëhet zotëruesi ligjor i kuotës në shitje menjëherë pas regjistrimit të kësaj kontrate pranë QKB. Në këtë mënyrë blerësi "Premium Contruction & Maintenance" shpk bëhet zotëruesi i ligjshëm në total për 25 (njëzet) % të kapitalit themeltar të shoqërisë Koncesionare "Vlora Harbor Construction & Maintanance" Shpk.

NENI 3

Çmimi i Shitjes

- 3.1 Çmimi i shitjes i pagueshëm nga blerësi "Premium Construction & Maintenance" shpk për 100% të kuotës që zotëron shitësi që përfaqësojnë 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë është 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, shume totale e cila do të paguhet nga blerësi "Premium Contruction & Maintenance" shpk në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 3.3 Pagesa do të kryhet në llogarinë e shoqërisë "ARKONSTUDIO" shpk në Bankën _____ me numër llogarie _____ dhe do të faktohet me ane të pasqyrave të llogarive bankare të shitësit dhe të blerësit.

NENI 4

Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit





A2022052820452989477

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton ne lidhje me transaksionin qe parashikohet ne këtë Kontrate, për te gjitha çështjet qe vijnë.
- 4.1.1 *Autorizimi* – Te gjitha veprimet, aktet dhe / ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe legjislacioni i vendit te regjistrimit te Shitësit dhe / ose aktet e shoqërisë "Vlora Harbor Construction & Maintenance" shpk qe duhet te ndërmerren nga ose për llogari te Shitësit dhe qe autorizojnë Shitësin te lidhe dhe te zbatoje këtë Kontrate janë kryer rregullisht. Kjo Kontrate është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim te vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.
- 4.1.2 *Nënshkrimi* – Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon asnjë depozitim, miratim, autorizim te çfarëdolloj nga ndonjë autoritet shtetëror ose pale e trete përveç miratimit nga asambleja e shoqërive qe janë pale ne këtë kontrate shpk.
- 4.1.3 *Pronësia* – Shitësi është pronari i vetëm dhe i ligjshëm i Kuotave ne shitje. Kuotat janë përcaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe janë shlyer plotësisht nëpërmjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te shoqërisë.
- 4.1.4 *Kuotat* - Kuotat janë te lira dhe te çliruara nga çdo Barre e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka te gjitha te drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plote për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotat ne përputhje me afatet e kësaj Kontrate. Nuk ka asnjë kontrate, marrëveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonjë Barre ne lidhje me Kuotat ose ndonjë numër Kuotash te autorizuar por te paemetuara ne kapitalin e shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë te drejte mbi ndonjë Barre lidhur me ndonjë nga Kuotat. Përveç kësaj Kontrate, nuk ka asnjë kontrate, marrëveshje, ose detyrim qe parashikon dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhënien e se drejtës një personi, te drejtën e parablerjes apo te këmbimit, ne lidhje me Kuotat objekt te kësaj kontrate.
- 4.1.5 Mbi blerësin nuk rendon asnjë detyrim i lindur mbi kuotat qe zotëron shitësi deri ne momentin e kalimit te pronësisë te saj.
- 4.1.6 Shitësi heq dore nga çdo pretendim ne lidhje me fitimin qe përfiton ne formën e dividendit ose çdo përfitim tjetër deri ne datën e transferimit te kuotave.

NENI 5

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

- 5.1 Blerësi deklaron dhe i jap garanci Shitësit se nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate nuk janë dhe nuk do te jene ne konflikt, ose nuk do te rezultojnë ne ndonjë shkelje apo mos përmbushje, te ndonjë kontrate, marrëveshjeje apo dispozitave te një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje te detyrueshme për Blerësin.
- 5.2 Me ane te kësaj kontrate, Blerësi behet zotërues i 100% (njëqind përqind) te kapitalit themeltar te shoqërisë te transferuara nga shitësi, dhe si rrjedhoje do te ndërmerr te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe vjen nga ky zotërim i kuotave.

Blerësi "Premium Contruction & Maintenance" shpk, bashke me 37% te kapitalit themeltar qe zotëronte para nënshkrimit te kësaj kontrate, behet zotërues i ligjshëm ne total për 62 (gjashtëdhjetë e dy) % te kapitalit themeltar te shoqërisë Koncesionare "Vlora Harbor Construction & Maintenance" shpk dhe si rrjedhoje do te ndërmarrë te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe vjen nga ky zotërim i kuotave.



- 5.3 Blerësi detyrohet të paguaje çmimin e përcaktuar të shitjes së kuotave sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate.



A2022052820452989477

Neni 6 Juridiksioni

- 6.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 6.2 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 7 Taksa dhe Shpenzime

- 7.1 Taksa për kalimin e kuotave do të paguhet nga Shitësi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 7.2 Shpenzimet noteriale do të paguhet nga blerësi.

NENI 8 Legjislacioni i Zbatueshëm

Kjo kontrate, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe veçanërisht, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me ndryshimet përkatëse.

NENI 9 Te ndryshme

- 9.1 Kjo Kontrate përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis Palëve që lidhet me objektin e kësaj Kontrate.
- 9.2 Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Pale.
- 9.3 Në rast se një dispozite ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket nga një fakt i tillë.
- 9.4 Palët do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozite të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën me të madhe të mundshme, për të arritur qëllimin e kësaj dispozite.
- 9.5 Asnjëra Pale nuk mund të kalojë dhe/ose të transferojë të drejtat dhe/ose detyrimet sipas kësaj Kontrate, në tërësi ose në veçanti, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.





A2022052820452989477

Kjo Kontrate nënshkruhet ne 5 (pese) kopje origjinale dhe identike nga unë noteria, një kopje ruhet ne arkivin e noterit dhe katër kopje u jepen palëve.

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITËSI
"ARKONSTUDIO" shpk

Nasjel Çiço

Administrator




BLERËSI
"Premium Contruction & Maintenance" shpk


Hektor Agalliu

Administrator





Notary
John W. John
1975-1976



RECEIVED
JUN 12 1964





VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
“PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE” SHPK

Nr. 3 datë 08 / 11 /2022

Sot, me datë 08 / 11 /2022, ne përputhje me dispozitat e statutit dhe te Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, u mbledh, pranë selisë së saj Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë **“PREMIUM CONSTRUCTION & MAINTENANCE” shpk** regjistruar si person juridik pranë QKR-se me nr. Nipt M11816005V me ortak te vetëm, me 100% te kuotave te kapitalit ne zotërim:

Z. Hektor Agalliu, atësia Nuri, amësia Zyrako, shtetas Shqiptar, lindur në Tërpan, Berat dhe banues në Dimal, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID nr. 033459666 dhe nr. personal F70127128J, për te diskutuar dhe vendosur për :

RENDI I DITËS :

Mbi blerjen e 25% te kuotave te ortakut –“ARKONSTUDIO” shpk tek shoqëria koncensionare **“Vlora Harbor Construction & Maintanance” shpk** me Nipt M21806032P me adrese Tirane, Rruga 365, Pall nr.8, kati 8, Apartamenti B, Tirane për vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë,

VENDOSI :

- Te blejë 25 % te kuotave te ortakut – shoqërisë “ARKONSTUDIO” shpk, tek shoqëria koncensionare **“Vlora Harbor Construction & Maintanance” shpk** me Nipt M21806032P me adrese Tirane, Rruga 365, Pall nr.8, kati 8, Apartamenti B, Tirane për vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- Bazuar në këtë vendim z. Hektor Agalliu autorizohet te nënshkruajë Kontratën e Shit-Blerjes së aksioneve .

ORTAKU I VETËM

HEKTOR AGALLIU

Hektor Agalliu





VENDIM

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQËRISË

“ARKONSTUDIO” SHPK

Nr. 4 datë 08 / 11 /2022

Sot, me datë 08 / 11 /2022, ne përputhje me dispozitat e statutit dhe te Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, u mbledh, pranë selisë se saj Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “**ARKONSTUDIO**” shpk regjistruar si person juridik pranë QKR-se me nr. Nipt L42019004I me ortake:

- z.Erjon Këri qe zotëron 1 kuote e cila përfaqëson 50% te kapitalit themeltar te shoqërisë dhe,
 - z.Krenar Dila qe zotëron 1 kuote e cila përfaqëson 50%t te kapitalit themeltar te shoqërisë
- , për te diskutuar dhe vendosur për :

RENDI I DITËS :

Mbi shitjen e kuotës qe shoqëria “**ARKONSTUDIO**” shpk zotëron tek shoqëria koncensionare “**Vlora Harbor Construction & Maintenance**” shpk me Nipt M21806032P me adrese Tirane, Rruga 365, Pall nr.8, kati 8, Apartamenti B, Tirane dhe qe përfaqëson 25% te kapitalit themeltar te kësaj shoqërie, tek shoqëria Premium Construction & Maintenance” shpk, regjistruar si person juridik pranë QKB-se me nr.Nipt M11816005V, për vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë,

VENDOSI :

1. Te shesë tek Shoqëria “Premium Construction & Maintenance” shpk, me Nr. Nipti M11816005V, kuotën qe shoqëria “**ARKONSTUDIO**” shpk, zotëron tek shoqëria koncensionare “**Vlora Harbor Construction & Maintenance**” shpk me Nipt







- M21806032P me adrese Tirane, Rruga 365, Pall nr.8, kati 8, Apartamenti B, Tirane, kuote e cila përfaqëson 25% te kapitalit themeltar te shoqërisë “Vlora Harbor Construction & Maintanance” shpk.
2. Shitja e kuotës sipas pikës 1 me sipër do te behet për vlerën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) leke.
 3. Bazuar në këtë vendim z. Nasjel Çiço autorizohet te nënshkruajë Kontratën e Shit- Blerjes se aksioneve .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE

“ARKONSTUDIO” SHPK

Z.Erjon Këri

Erjon Këri

Z.Krenar Dila

Krenar Dila





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-2022110916748573
Data e Rezultatit të Kerkimit: 09.11.2022
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 4:07:48PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-221-5085
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

VLORA HARBOR CONSTRUCTION AND MAINTANANCE SH.P.K.



*Samir
Cezaj*






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M21806032P	
2. Data e Regjistrimit	06/06/2022	
3. Emri i Subjektit	Vlora Harbor Construction and Maintanance	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	28/05/2022	
6. Kohëzgjatja	Nga: 28/05/2022	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Tirane, Rruga 365 , Pll nr 8,kati 8 ,Apartamenti B Tirane.	
8. Kapitali	1.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	4,00	
9. Objekti i aktivitetit	Shoqeria Koncesionare "Vlora Harbor Construction and Maintanace " sh.p.k eshte subjekt i themeluar per qellim te vecante dhe ka per objekt te veprimtarise zbatimin dhe permbushjen e kushteve te Kontrates se Koncesionit nr. 554 Rep. NR 203 Kol date 29.04.2022 te lidhur midis Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures 'Autoriteti Kontraktues' dhe Koncesionarit, me objekt Projektimi ndertimi dhe mirembajtaj e Portit te Integruar ne Triport Vlore , si dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjeter te nevojshem, ndihmes apo plotesues ne funksion te zbatimit dhe permbushjes se kushteve te kontrates se koncesionit.	
10. Administratori/ët	Hektor Agalliu	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 28/05/2022	Deri: 28/05/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	I T E. GRUP	
12.1 Vlera e kapitalit		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.2 Numri i pjesëve	Para: 80.000,00	Natyre:
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00	
	8,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	Premium Construction & Maintenance	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 370.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	37,00	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Ortakët	BESTA	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 300.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	30,00	
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Ortakët	ARKONSTUDIO	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 250.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
15.4 Komente (nëse ka)		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Vlora Harbor Construction and Maintenance E-Mail: vloraharborem@gmail.com Telefon: 0692426599	
18. Statusi:	Aktiv	

Datë: 05/11/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2022/11/05 15:26:11 +01:00
M21806032P2022110515260254
2006



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M11816005V
2. Data e Regjistrimit	16/06/2021
3. Emri i Subjektit	Premium Construction & Maintenance
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	09/06/2021
6. Kohëzgjatja	Nga: 09/06/2021
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga 365, Pallati Nr.8, Kati i 8, Apartamenti B
8. Kapitali	10.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Ndertim Infrastrukture , ndertime civile , industriale, turistike. Ndertime rrugore, ndertime hidroteknike, rikonstruksione godinash civile.Ndertimin e rrjeteve inxhinierike. Projektim, zbatim, mirembajtje periodike, riparim dhe rehabilitim ne fushen e automatizimit industrial ne makineri , mjete, pajisje, sisteme. Tregtim te artikujve te ndryshem me pakice e shumice, industriale e ushqimore, bujqesore, blegtorale, lengjeve te frutave, pijeve alkolike, ujit - si dhe eksporti i tyre. Tregtim materiale ndertimi, inerte, rere, mermer, etj.Tregtim makineri-e-pjese-kembimi per llojet e ndryshme te makinerive. Prodhim materiale ndertimi. Import-eksport karburantesh dhe transport i tyre. Agjensi udhetimesh, shitje bileta avioni e traget.Transport mallrash e pasagjeresh brenda dhe jashte vendit, hoteleri. Ndertim dhe menaxhim i objekteve turistike. Menaxhim i fushave te golfit. Agjensi turistike. Agjensi imobiliare. Kryerje analizash laboratorike te materialeve te ndertimit te ndryshme elektrike, elektronike, mekanike si : Sisteme, impiante, linja te trajtimit te mbetjeve; sistemime, impiante,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	linja komandimi per HEC- e, centrale, nenstacione TN, TM, TU; sistemime, impiante, linja ne mjete te renda transporti, paisje ulese -ngritese si ashensore, vinça mobil portual dhe civil, vinça elektrike portual dhe civil; sisteme, impiante, linja automatizimi ne industri; sisteme, impiante, linja kapanone te lidhura me prodhimin; sisteme, impiante, linja te ftohjes dhe te ngrohjes (kondicionimit) Veprimtari e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis, vleresim ndikimi ne mjedis (auditimi mjedisor). Veprimtari te tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, grumbullim mdhe trasportim i mbetjeve te ndertimit dhe prishjeve dhe mbetjeve te ngurta urbane. Blerje pjese kembimi. Grumbullim dhe transport i mbetjeve nga ujrat e ndotura. Mirembajtje, operim, menaxhim rruge, tynele, ura, mbikalime. Transport i mbetjeve te llumrave me permbajtje hidrokarbure . Ndertim i tuneleve, urave, mbikalimeve.Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane. Grumbullim , ruajtje dhe transportim i mbetjeve urbane, mbetjeve jo te rrezikshme etjer. Shoqeria do te realizoje, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti lidhur me, si rezultat i, apo qe ka lidhje me objektin e saj. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma, agjensi dhe ndermarrje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktivitetit. Gjithashtu, per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurise se luajtshme e te paluajtshme, si edhe cdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhenes apo dorezenes, qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.	
10. Administratori/ët	Hektor Agalliu	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 09/06/2021	Deri: 09/06/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Hektor Agalliu	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 10.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)	
12.4 Komentë (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Premium Construction & Maintenance E-Mail: hektoragalliu@gmail.com Telefon: 0692426559
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 05/11/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2022/11/05 15:30:45 +01:00
M11816005V2022110515303595
2006

100-443886-100




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L42019004I
2. Data e Regjistrimit	19/08/2014
3. Emri i Subjektit	ARKONSTUDIO
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	18/08/2014
6. Kohëzgjatja	Nga: 18/08/2014
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33
8. Kapitali	60.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Studio projektimi, supervizioni dhe kolaudimi: Masterplane - studime e plane racionale urbanistike, plan rregullues të përgjithshëm për qendra të banuara - qytete, studime pjesore urbanistike, projektim objekte civile - industrial - turistike deri 5 kate dhe mbi 5 kate, projektim objekte sportive, projektim interiere, projektim pejsazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbert, lulishte e parqe, objekte civile - industrial - turistike prej murature e skelet beton/arme deri në 5 kate dhe mbi 5 kate - objekt me skelet metalik, objekt me shkallë të lartë vështiresie b/arme, metalike, troje dhe shpate me qendrushmeri të ulet, instalime h/sanitare, instalime termoteknike - ventilim - kondicionim, linja e rrjete elektrike - telefonike - radiotelefoni - citofoni - sisteme alarmi - televiziv për objekte civile, industriale, turistike, sisteme komplekse të telekomunikacionit, sisteme të furnizimit me gaz, diga, galeri, tunele, furnizim me ujë - kolektor shkarkimi, ujesjelles kanalizime urbane e rurale, vepra ujitje - kullimi - ujë kolektor shkarkimi, ujesjelles kanalizime urbane e rurale, vepra ujitje - kullimi impjante vaditese - diga deri 10 m - damba, vepra të trajtimit të ujit, vepra





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

hidroteknike: marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri, porte e pontile, vepra naftesjellese - gazsjelles - vajsjelles, rruge auto kategori e I deri V, shtresa rrugore e sistemim asfaltim, autostrada, pista, aeroporte, heliporte, hekurudha e degezime hekurudhore, ura dhe vepra arti mbi 10 m, estakada, ura metalike dhe te varura, tunele rrugore e hekurudhore, centrale hidraulike dhe termike, impiante te prodhimit dhe shperndarjes te energjiese elektrike - diellor - ere, nenstacione elektrike, primare e sekondare - linja te tensionit te larte, kabina elektrike te rrjetit shperndares - linja te tensionit te ulet dhe te mesem, sinjalizime ne rruge auto kategori I deri V, autostrada dhe degezime me hekurudhen, sinjalizime ne aeroporte dhe heliporte. Shoqeri ndertimi: punime germimi, objekte civile - industrial - turistike deri 5 kate dhe mbi 5 kate objekte civile - industrial - turistike prej murature e skelet beton/arme deri ne 5 kate dhe mbi 5 kate-objekt me skelet metalik, objekt me shkalle te larte veshtiresie b/arme, metalike, troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet, instalime h/sanitare, instalime termoteknike - ventilim - kondicionim, linja e rrjete elektrike - telefonike - radiotelefoni - citofoni - sisteme alarmi - televiziv per objekte civile, industriale, turistike, sisteme komplekse te telekomunikacionit, sisteme te furnizimit me gaz, diga, galeri, tunele, furnizim me uje - kolektor shkarkimi, ujesjelles kanalizime urbane e rurale, vepra ujitje - kullimi - impjante vaditese - diga deri 10 m - damba, vepra te trajtimit te ujit, vepra hidroteknike: marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri, porte e pontile, vepra naftesjellese - gazsjelles - vajsjelles, rruge auto kategori e I deri V, shtresa rrugore e sistemim asfaltim, autostrada, pista, aeroporte, heliporte, hekurudha e degezime hekurudhore, ura dhe vepra arti mbi 10 m, estakada, ura metalike dhe te varura, tunele rrugore e hekurudhore, centrale hidraulike dhe termike, impiante te prodhimit dhe shperndarjes te energjiese elektrike - diellor - ere, nenstacione elektrike, primare e sekondare - linja te tensionit te larte, kabina elektrike te rrjetit shperndares - linja te tensionit te ulet dhe te mesem, sinjalizime ne rruge auto kategori I deri V, autostrada dhe degezime me hekurudhen, sinjalizime ne aeroporte dhe heliporte. Ushtrim veprimtarie per shit - blerje materiale ndertimi te vendit dhe importi qe perdoren per qellime ndertimi. Objekti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	i veprimtarise se shoqerise ne projektim, supervizion, kolaudim dhe ndertim behet ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Sherbime ekspertize dhe / ose profesionale te mbrojtjes civile. Sherbim ekspertize per: Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji. Hartimin e akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Auditim ne fushen e energjise / shoqeri e sherbimeve energjitike.	
10. Administratori/ët	Nasjel Çiço	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 13/03/2019	Deri: 13/03/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Sokol Toska	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 28/02/2017	Deri:
13. Ortakët	ErjonKëri	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 30.000.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Ortakët	KrenarDila	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 30.000.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ARKONSTUDIO E-Mail: info.arkonstudio@gmail.com Telefon: 0672020481	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

17. Statusi:	Aktiv
--------------	-------

Datë: 07/11/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2022/11/07 15:45:29 +01:00
L42019004I20221107154520242
006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

